



BASHKIA
TIRANË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Bashkia e Tiranës
Adresa: Bulevardi “Deshmoret e Kombit”
Tel/Fax: 00 355 4 22 56 799
E-mail: prokurimet@tirana.gov.al
Faqja e Internetit: www.tirana.gov.al

Emri dhe adresa e personit të kontaktit

Emri: Z. Genc Kojdheli
Adresa: Bulevardi Deshmoret e Kombit,
Tel:
Faks:
E-mail: genc.kojdheli@tirana.al

Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore

Institucion qëndror <input type="checkbox"/>	Institucion i pavarur <input type="checkbox"/>
Njësi e Qeverisjes Vendore <input checked="" type="checkbox"/>	Tjetër <input type="checkbox"/>

SEKSIONI II Objekti i kontratës

II.1 Lloji i kontratës

Punë <input checked="" type="checkbox"/>	Shërbime <input type="checkbox"/>
---	--------------------------------------

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncensionit/partneritetit publik privat

II.2.1 Objekti i Kontratës:

Bashkia e Tiranës ose "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare tenderimi për Partneritetin Publik Privat për hartimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të një terminali të ri të transportit publik, mirëmbajtjen e tij të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, si dhe menaxhimin e mëvonshëm të terminalit të transportit publik të Tiranës ("**Projekti**") siç përcaktohet në *Shtojcën 14 Termat e Referencës*, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës të dhëna në *Shtojcën 17 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës* dhe *Shtojcën 18 Kushtet e Veçanta të Kontratës*. Vlera e vlerësuar e projektit është 15.5 milionë Euro. Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur të tenderit në pajtim me nenin 22 të ligjit shqiptar të koncesioneve dhe partneritetit publik privat nr. 125/2013. Autoriteti kontraktor do të marrë parasysh vetëm ofertat e atyre tenderuesve apo konsorciumet e tenderuesve, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit (*Shtojca 9 Dëshmi Kualifikimi / Formularin e Pjesëmarrjes*).

Gjatë ndërtimit të terminalit, objektivi i Autoritetit Kontraktor është përmirësimi i lëvizshmërisë së përgjithshme, duke siguruar një terminal me kapacitet të plotë transporti ku autobusët ndërqytetës do të shkarkojnë pasagjerë për në autobusë urbanë dhe taksi përgjatë korridorit kryesor të qytetit në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore të vendit, duke zvogëluar bllokimet e trafikut në qendër të qytetit, përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e konsumit të karburantit për transport publik.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një truall prej 85,000 metra katrorë vendosur përgjatë korridorit kryesor që çon në veri-perëndim, nga qyteti në drejtim të Durrësit, truall i cili do t'i kontraktohet në baza afatgjatë Ofertuesit fitues për të ndërtuar, operuar dhe për të ruajtur terminalin për të mirën e operatorëve dhe udhëtarëve. Në shkëmbim, të gjitha tarifat e vendqendrimit të autobusëve, të ardhurat e qiradhënies me pakicë, dhe tarifat e parkimit, do të arkëtohen nga Operatori Ekonomik për amortizimin e CAPEX-it të tij fillestar, shpenzimet operative, dhe për mbulimin e shërbimit të borxhit.

Kontrata do të jepet përmes një procesi konkurrues ndërkombëtar ofertimi, duke ndjekur procedurën e përshkruar në këtë Dokument Ofertues.

Tenderimi për kontratën është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta të firmave e çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në *Shtojcën 9 Dëshmi Kualifikimi/Formulari i Pjesëmarrjes*.

II.2.2 Forma e kontratës

Kontratë Partneriteti Publik Privat për koncesionin e punëve publike.

II.2.3 Burimi i Financimit

Sektor Privat

II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin e saj

Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncesionit do të jetë ajo e ofruar nga Ofertuesi fitues (ndërmjet 15 dhe 35 vitesh).

II.4 Vendodhja e objektit të kontratës

Ky projekt ndodhet në Tiranë.

